



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSA STUDIMI BACHELOR/ MASTER /
DOKTORATURË NË REPUBLIKËN ÇEKE, VITI AKADEMIK 2024-2025**

Ambasada e Republikës së Çekisë njofton se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke ofron për studentët shqiptarë 3 (tre) bursa të plota për studime doktorale PhD/Master/Bachelor për vitin akademik 2024-2025.

Kushtet e pranimit dhe kërkesat në lidhje me gjuhën e shkollimit përcaktohen në mënyrë autonome nga universitetet pritëse, të cilat marrin vendime të pavarura nëse çdo aplikant mund të pranohet ose jo në kuadrin e programit të bursave.

Një informacion i detajuar rreth formës së aplikimit dhe dokumentave të tjerë gjendet në website-in e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke: <https://www.msmt.cz/eu-and-international-affairs/scholarships-for-the-academic-year-2024-2025>

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet postës, brenda datës 25 mars 2024, dokumentacionin përkatës në anglisht sipas listës në vijim:

- Formularin e aplikimit;
- Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit;
- Kopjen e noterizuar të listës së notave;
- Vërtetimin nga universiteti përkatës për kandidatët që ndjekin aktualisht studimet universitare;
- Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
- 2 (dy) fotografi;
- Plani i detajuar i studimit/kërkimit;
- Dy letra rekomandimi nga mbikëqyrësit akademikë ose një punëdhënës
- CV në anglisht.